

QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT



Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët nr. 601, datë 04.09.2019 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QSPA do të shpallë në faqen zyrtare të internetit konkursin për pozicionin:

PASQYRA E PUNËS

POZICIONI I PUNËS	Kërkues shkencor në media
DEPARTAMENTI	Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve
ADRESA E QSPA	Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, nr. 7/4, Tiranë
RAPORTON TEK	Drejtori i Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve

PËRSHKRIMI I PUNËS (DREJTORIA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE)

Objekti i punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve është:

- Nxit dhe bashkërendon veprimtaritë e QSPA-së me institucione të tjera që kanë lidhje me këto veprimtari;
- Harton dhe mbikëqyr veprimet për realizimin e veprimtarive të institucionit;
- Vendos dhe mban lidhje me shoqatat, organizatat, qendrat, përfaqësitë brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë komunitetin Arbëresh si objekt të veprimtarisë së tyre;
- Ndjek korrespondencën me institucione dhe organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në lidhje me studimet dhe publikimet për Arbëreshët;
- Merr pjesë në organizimin e konferencave dhe seminareve shkencorë, të cilat i mbështet me ide, përmbajtje dhe organizim.

- Kryen studime themelore në fushën e tij/saj të specialitetit, e cila është një nga disiplinat, apo një kombinim i disiplinave të shkencave sociale të aplikuara mbi komunitetet arbëreshe si :
 - **Media;**
- Ndhmon në konceptimin, përgatitjen, realizimin dhe monitorimin e aktiviteteve edukative mbi njohjen dhe ruajtjen e identitetit dhe kulturës arbëreshe;
- Përgatit përmbajtjen e lajmeve dhe të buletinit informativ periodik të QSPA-së;
- Shkruan dhe publikon, në suportet e QSPA-së si faqja web dhe suportet e tjera të komunikimit elektronik, botimet e QSPA-së, aktivitetet, shtypin periodik të QSPA-së, etj.
- Krijon dhe menaxhon strategjinë për mbarëvajtjen e rrjeteve sociale të QSPA-së;
- Të jetë i aftë të realizojë, përveç kërkimit shkencor në disipinën përkatëse, një apo disa nga aktivitetet që hyjnë në objektin e punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve, të cilat do t’i caktohen nga eprorët sipas nevojave të kalendarit të veprimtarive;

EDUKIMI DHE TRAINIMET

Edukimi dhe eksperiencia që kërkojmë:

- Të zotërojë gradë/titull shkencor "doktor" në fushat që kanë prekje me komunikimin, shkencat sociale;
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë në fushën e kërkimit shkencor në fushat e mësipërme.
- Të ketë njohuri mbi historinë e arbëreshëve ;
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në fushën e kërkimit shkencor në fushat e mësipërme;
- Të ketë aktivitet kërkimor-shkencor në disiplinën përkatëse;
- Të përmbushë kriteret e punësimit që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi;
- Të jetë i certifikuar në gjuhë të huaj, minimumi niveli C1 (Italisht ose Anglisht).

AFTËSITË

- Aftësi vendimmarrëse dhe interpretuese
- Aftësi pune në grup
- Komunikim shumë i mirë
- Aftësi të mira në përballimin e punës nën presion

KUSHTET E PUNËS

MJEDISI I PUNËS

Mjedisi i punës, karakterizohet nga ambientet e përshtatshme dhe të mirë organizuara për punën kërkimore e studimore.

ORARI I PUNËS

Nga e hëna në të enjte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 16:30.
Ditën e premte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim ku shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e punës.
2. Jetëshkrim (CV) në formatin EuroPass.
3. Fotokopje të diplomave universitare dhe të gradës/titujve shkencorë "Doktor"
4. Referencë nga të paktën një profesor
5. Fotokopje të librezës së punës ose vërtetime nga punëdhënësit, të cilat vërtetojnë eksperiencën në punë.
6. Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj.
7. Certifikata që vërtetojnë zotërimin e gjuhës së huaj.
8. Vetë deklaram të gjendjes gjyqësore
9. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të bëhet brenda datës 07/07/2022 ora 14:00, në Zyrën e Protokollit të QSPA-së në rrugën "Ibrahim Rugova", pallatit "Sky Tower", kati i shtatë, ap. 4, si dhe në adresën e e-mail: info@qspa.gov.al

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurimit

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QSPA-ja, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).